REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

# VENDIM

Nr. 122, datë 3.3.2021

## PËR

## MIRATIMIN E KATEGORISË SË NDËRTESAVE QË PËRJASHTOHEN NGA LIGJI NR.116/2016, "PËR PERFORMANCËN E ENERGJISË SË NDËRTESAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 4, të ligjit nr.116/2016, "Për performancën e energjisë së ndërtesave", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Përjashtohen nga zbatimi i ligjit nr.116/2016, "Për performancën e energjisë së ndërtesave", objektet që do të ndërtohen në zbatim të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", dhe ndërtimi i të cilave miratohet nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit dhe Agjencia për Efiçencën e Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

NR.PROT. 1174/1
DATË 5. 3. 2021

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
KOMISIONIT SHTETËROR TË RINDËRTIMIT
AGJENCISË PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE